

## KOMUNIKIM PËR SHTYP

### Crédit Agricole Group konfirmon pozitat e tij solide gjatë 3-mujorit të parë të 2012-ës

#### Rezultatet e Crédit Agricole Group për 3-mujorin e parë

*Të ardhura: Eur 804 milionë  
Core Tier 1: 10.4%*

Gjatë 3-mujorit të parë të vitit 2012 Crédit Agricole Group gjeneroi 804 milion të ardhura neto. Jean-Marie Sander Drejtor i Bordit të Crédit Agricole S.A. theksoi se këto rezultate reflektojnë një moment solid të linjave të biznesit të grupit dhe të rritjes së kontrolluar në përputhje me objektivat.

Në këtë 3-mujor të parë Crédit Agricole Group vazhdoi të zhvillojë aktivitetin e tij për t'i shërbyer klientelës dhe ekonomisë. Në rrjetin e grupit në Francë kreditë në retail u rritën 4.1% në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, kurse niveli i depozitave u ngrit me 8.1%.

Bankat Rajonale në veçanti vazhduan të mbështetin të gjithë segmentet e klientelës, duke filluar nga kreditimi për shtëpi, portofoli i të cilit u rrit me 5.8% më shumë se në 2011-ën, si dhe në kreditimin e klientëve të korporatave dhe biznesit të vogël në nivelin 1.7% më shumë se vitin e kaluar. Bankat Rajonale kanë punuar gjithashtu për të forcuar bilancin e depozitave të cilat u rritën me 6.3%.

Si rezultat i këtij aktiviteti dinamik të ardhurat e grupit u rritën me 1.3% krahasuar me një vit më parë dhe të ardhurat operacionale me 3.2%, si rezultat i kostove të mirëkontrolluara të cilat vazhduan të ishin të qëndrueshme.

Në terma të likuiditetit në 31 Mars 2012 Core Tier 1 ishte 10.4%.

#### **Banka Emporiki Shqipëri**

---

Gjatë 4-mujorit të parë për vitin 2012 Banka Emporiki Shqipëri rriti në mënyrë të përmbajtur kreditimin e klientelës dhe ngriti ndjeshëm nivelin e depozitave. Trendi i këtyre dy treguesve të rendësishëm është në përputhje me strategjinë e bankës për vitin 2012 për konsolidimin e mëtejshëm të pozicionit të saj të likuiditetit.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe kapitali i bankës u rrit në nivelin 9%. Të ardhurat bruto u rritën në 3.5 milion euro kurse numri i klientëve me 4% duke shkuar 32,300, ndërkohë që shpenzimet u ulën duke kontribuar kështu në rritjen e fitimit neto në fund të Prillit 2012.

---

#### **Kontakte:**

Mirela Xhelollari / Tel +355 2258 755 ext. 261 / E-mail: [marketing@emporiki.com.al](mailto:marketing@emporiki.com.al)

Banka Emporiki Shqipëri është 100% pjesë e grupit të fuqishëm bankar Crédit Agricole Group, i cili është lider në Francë për Retail dhe një nga grupet më të mëdha bankare në botë, me 160'000 punonjës, 54 milionë klientë dhe 11'600 degë.

Emporiki është prezente në tregun shqiptar që prej vitit 1999, ofron një gamë të gjerë shërbimesh dhe produktesh bankare për individë, biznese dhe institucione publike nëpërmjet rrjetit të saj prej 22 degëve në të gjithë vendin. Profesionalizmi, fleksibiliteti, konkurrenca, dinamizmi, përshtatshmëria dhe fokusimi te klienti janë vlerat e Bankës Emporiki Shqipëri.

---

**Kontakte:**

Mirela Xhelollari / Tel +355 2258 755 ext. 261 / E-mail: [marketing@emporiki.com.al](mailto:marketing@emporiki.com.al)